



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

Projekti Drejtësi për të gjithë - Shqipëri

KËRKESË PËR APLIKIME (RFA-JAG-2017-004)

Mbështetje ndaj Gazetarisë Investigative

I. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti “Drejtësi për të Gjithë” i USAID-it (në tekstin e mëtejshëm “Projekti”) është një projekt pesë vjeçar (2016-2021) i hartuar për të përmirësuar performancën e gjykatave përmes zbatimit të standardeve gjithëpërfshirëse të performancës gjyqësore lidhur me efikasitetin, transparencën, aksesueshmërinë dhe llogaridhënien. Projekti i ofron ndihmë dhe mediave dhe gazetarisë investigative, si dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC-të) për të forcuar rolin e tyre si aktorë të rëndësishëm në procesin e reformës në drejtësi dhe si mbikëqyrës të zbatimit të reformave. Qëllimi përfundimtar i projektit është të rrisë besimin e publikut në sistemin gjyqësor shqiptar.

II. PËRSHKRIMI I MUNDËSIVE PËR FINANCIM

Korrupsioni mbetet një sfidë e madhe për zhvillimin politik, ekonomik dhe social të Shqipërisë. Në studimin e 2016 “Rezultatet e Sistemit të Monitorimit të Korrupsionit për Shqipërinë”, kryer nga Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER) tregohet se një në dy prej të anketuarve pranuan që iu është kërkuar direkt ose indirekt t’u japin ryshfet zyrtarëve publikë (49.6%)¹. Sondazhi gjithashtu tregon se qytetarët i perceptojnë gjyqtarët, zyrtarët e doganave, zyrtarët publikë, partitë politike dhe liderët politikë të jenë segmentet më të korruptuara të shoqërisë, sipas kësaj renditje.

Korrupsioni në sistemin gjyqësor shqiptar është i përhapur dhe paraqet rrezik shumë të lartë për qytetarët dhe bizneset. Një studim i kryer nga Instituti Shqiptar për Zhvillim dhe Kërkime Alternative (IDRA), konfirmon se qytetarët i shohin prokurorët dhe gjyqtarët si më të korruptuarit në mesin e zyrtarëve publikë². Raporti i Integritetit për Shqipërinë GAN 2016 tregon se ryshfetet shpesh shkëmbehen me vendime gjyqësore të favorshme, dhe gjyqtarët dhe prokurorët nuk kanë llogaridhënie³.

Në parim, krimet ekonomike dhe të organizuara janë shpesh të ndërlidhur me pjesë të gjyqësorit. Raportet e organizatave dhe organizmave ndërkombëtare, duke përfshirë Bashkimin Evropian (BE), tregojnë se Shqipëria “ka arritur një nivel të përgatitjes sa i përket luftës kundër krimit të organizuar”. Bashkimi Evropian në Raport Progresin e tij të fundit për Shqipërinë, thekson se një sërë aksionesh në zbatim të ligjit kanë çuar në asgjësimin e madh të kanabisit. “Megjithatë, numri i dënimeve përfundimtare efektive që çon në shpërbërjen e organizatave kriminale mbetet i papërfillshëm në krahasim me çmimin e vlerësuar të tregut kriminal të brendshëm dhe rajonal. Hetimet financiare, masat kundër pastrimit të parave dhe konfiskimi i aseteve mbeten të pazbatuara siç duhet. Shqipëria duhet të krijojë një sistem gjurmimi dhe monitorimi të hetimeve proaktive, ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare në rastet e krimit të organizuar, duke përfshirë pastrimin e parave, dhe të eliminojë në mënyrë efektive rrjetet kriminale”.

¹ Raporti i Vlerësimeve të korrupsionit në Shqipëri 2016 http://seldi.net/fileadmin/public/PDF/Publications/CAR_Albania_2016/Raporti_i_Vleresimit_te_Korrupsionit_2016.pdf

² “Korrupsioni në Shqipëri: perceptime dhe përvoja 2015-2016”

http://www.idrainstitute.org/files/reports/Corruption%202016/Gjetjet%20Krvësore%20Studimi%20i%20Korrupsionit%20IDRA%20_Grafike.pdf

³ <http://www.business-anti-corruption.com/country-profiles/albania>

Media luan një rol të madh në ekspozimin e korrupsionit, keqpërdorimit të pushtetit, krimin të organizuar dhe ekonomik. Shembuj frymëzues të gazetarëve që kanë ekspozuar korrupsionin dhe krimet në shumë vende të botës dëshmojnë për fuqinë e jashtëzakonshme të medias për të luftuar korrupsionin dhe krimin, por edhe për të gjallëruar debatin publik dhe për të rritur ndjenjën e përgjegjësisë në mesin e politikanëve, organizmave publikë dhe institucioneve.

Projekti synon të akordojë grante për të mbështetur gazetarinë investigative në fushat që përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm, në: (i) korrupsionin dhe abuzimin e pushtetit në sektorin publik dhe privat; (ii) në krimin e organizuar; (iii) në krimet ekonomike; (iv) në trajtimin e rasteve të korrupsionit, krimin ekonomik dhe raste të krimin të organizuar nga ana e sistemit të drejtësisë - policisë, prokurorëve, gjyqtarëve-; (v) korrupsionin e lidhur me veprimtari politike, duke përfshirë financimin e partive. Këto grante do të jenë në dispozicion për gazetarët individualë ose ekipe të gazetarëve.

Shkrimet (në formë teksti/audiovizuale) që do të mbështeten nga Projekti përmes kësaj KPA-je do të publikohen në faqen e internetit të Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative (BIRN) në www.reporter.al. Publikimi në media të tjera është gjithashtu i mundshëm.

Projekti kërkon aplikime krijuese, inovative në mbështetje të aktiviteteve që do të kontribuojnë në arritjen e objektivave të mëposhtme:

- Të ekspozojë korrupsionin dhe keqbërjen përmes raportimit të plotë, të thelluar, shumë cilësor, të bazuar në fakte, veçanërisht në sistemin e drejtësisë dhe krimeve komplekse kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Të ekspozojë lidhjet midis gjyqësorit dhe krimin të organizuar/ekonomik;
- Të ekspozojë krimet e organizuara dhe/ose ekonomike, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar vetëm në trafikimin e lëndëve narkotike, qënieve njerëzore, pastrimit të parave që mund të çojnë drejt ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare, si dhe të ndihmojnë për të eliminuar në mënyrë efektive rrjetet kriminale;
- Të ekspozojë korrupsionin në sferën politike, duke përfshirë financimin e partive politike;
- Të ekspozojë padrejtësitë, korrupsionin apo shpërdorimin e pushtetit, në sektorët publik dhe privat.

Aplikimet duhet të adresojnë në mënyrë specifike një ose më shumë prej objektivave të renditur më sipër. Përveç kësaj, që të merren parasysh, të gjitha aplikimet duhet të përfshijnë elementet e kërkuara në shtojcën A: *Formularin e Aplikimit për Grant* dhe duhet të propozojnë strategji për zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të kërkuara nga granti.

Kriteret e përzgjedhjes do të përfshijnë ndër të tjera: (i) rëndësinë e temës së propozuar të investigimit; (ii) punën e mëparshme të aplikantit; (iii) efikasitetin e idesë së propozuar; (iv) sa mundësi ka që ky investigim të përfundojë; dhe (v) sa mundësi ka që shkrimi i propozuar të publikohet/transmetohet dhe shpërndahet gjerësisht.

Projekti nuk do të shqyrtojë aplikimet që përfshijnë aktivitetet e mëposhtme:

1. Mbështetje për apo lobim për llogari të një partie politike;
2. Aktivitetet fetare;
3. Aktivitetet humanitare;
4. Hulumtime teorike;
5. Të gjitha aktivitetet e ndërtimit.

III. AKORDIMI I GRANTEVE

Projekti planifikon të akordojë grante për projekte që zgjasin nga 2 (dy) deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj. Fondet e Grantit mund të përdoren vetëm për aktivitetet që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e projektit. Akordimi i granteve do të bëhet në kategoritë e mëposhtme:

Grante të vogla për shkrime investigative: Deri në \$2000.00

Grante të mesme për shkrime investigative të një natyre më komplekse: Deri në \$5000.00

Grantet do t'u jepen gazetarëve individualë ose ekipeve të gazetarëve.

Projekti rezervon të drejtën për të akorduar një grant ose asnjë në përgjigje të çdo aplikimi të pranuar. Aplikantët duhet të ndërmarrin të gjitha kostot dhe rreziqet që lidhen me përgatitjen e çdo propozimi të paraqitur në përputhje me këtë KPA. Më tej, Projekti rezervon të drejtën për të pranuar ose refuzuar ndonjë ose të gjitha aplikimet e marra dhe ka të drejtë të kërkojë sqarime shtesë nga aplikantët.

IV. AFATET KOHORE

Të gjitha propozimet duhet të përfshijnë një afat kohor të udhëhequr nga afatet e mëposhtme:

Hapja e Ftesës për Propozime:	24 mars, 2017
Afati për Paraqitjen e Pyetjeve:	Në vazhdimësi – të gjitha përgjigjet do të publikohen në: http://www.ewmi.org/JFA
Dhënia e Përgjigjeve:	Në vazhdimësi – Pyetjet do të marrin përgjigje dhe përgjigjet do të postohen brenda 3 ditëve të punës nga marrja e tyre.
Afati Përfundimtar i Dorëzimit:	Në vazhdimësi – Afati i fundit për dorëzime në këtë thirrje është 15 gusht, 2017.
Shqyrtimi i Propozimeve:	Në vazhdimësi – Të gjitha propozimet do të shqyrtohen nga Komiteti i caktuar për Vlerësimin e Granteve brenda 10 ditëve të punës pas pranimit të tyre.
Shpallja e Vendimit Përfundimtar për Fituesit e Grantit:	Në vazhdimësi – Aplikantët do të njoftohen për vendimin përfundimtar në lidhje me aplikimin e tyre brenda 20 ditëve të punës pas pranimit të aplikimit.

Aplikimet do të pranohen deri në 15 gusht, 2017 dhe akordimi i granteve për këtë thirrje mund të bëhet deri më 30 shtator, 2017 ose deri në kohën kur është akorduar i gjithë fondi.

Ju lutemi vini re se datat e vlerësimit dhe akordimit mund të ndryshojnë.

V. KRITERET E PRANUESHMËRISË

Projekti kërkon aplikime nga gazetarë apo ekipe gazetarësh që punojnë në shtyp, transmetim, media online, dhe gazetarë të pavarur/freelance në Shqipëri. Aplikimet mund të dorëzohen nga gazetarët individualë ose nga një ekip gazetarësh. Ekipet do të emërojnë një prej anëtarëve si personin kryesor përgjegjës në lidhje me Projektin.

Aplikimet duhet të përmbushin edhe kriteret e mëposhtme:

- Investigimi duhet të zbulojë informacione të reja dhe të rëndësishme me interes të qartë publik;
- Gazetari tashmë ka informacione të rëndësishme (burime të posaçme, raste të veçanta, dokumente dhe të dhëna) në lidhje me temën e investigimit dhe aksesit në informacionet shtesë është real;
- Investigimi nuk duhet të paraqesë një rrezik të paarsyeshëm për gazetarët pjesëmarrës;
- Duhet të sigurohet një afat kohor realist për përmbushjen e raportimit investigativ të propozuar;
- Gazetari duhet të marrë pjesë në seminare hapëse dhe ato përfundimtare si dhe në trajnimet që projekti do të organizojë me përfituesit e granteve sipas kësaj KPA-je; ai/ajo duhet të bashkëpunojë me redaktorët e Projektit dhe trajnuesit gjatë gjithë zbatimit të aktiviteteve të mbështetura nga granti;
- Gazetari duhet t'i përgjigjet kërkesave të stafit të Projektit gjatë punës investigative;
- Gazetari pritet të përmbushë standardet profesionale gazetareske dhe standartet etike në zbatimin e aktiviteteve të mbështetura nga granti;
- Gazetari nuk duhet të jetë debitor, dhe duhet të ketë shlyer të gjitha borxhet ndaj shtetit, ose të ketë arritur në marrëveshje për pagesën e plotë të borxhit përpara përfitimit të kështit të parë të fondeve nga granti i Projektit (*kjo përjashton pagesat për kreditë private në bankat komerciale apo kredi të institucioneve të tjera*);
- Gazetari nuk duhet të jetë i ndaluar, pezulluar, përjashtuar, ose i papranueshëm për të përfituar fonde Federale të SHBA-së.
- Personeli i shoqërive publike të transmetimit nuk mund të marrë pjesë në një projekt të financuar me grante si një drejtor, menaxher i projektit apo si një pjesëmarrës i shpërblyer me fonde nga granti.

Aplikantët e zgjedhur për përftimin e granteve do t'i nënshtrohen një vlerësimi paraprak rrezikshmërie të kryer nga Projekti, për të përcaktuar nëse aplikanti ka kapacitetet minimale profesionale dhe menaxhuese që kërkohen për të punuar me fonde të Qeverisë së SHBA-së. Për këtë arsye, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, Projekti mund të kërkojë dokumentacion shtesë, që përfshin, por nuk kufizohet në shkrimet e mëparshme:

VI. PROCESI I VLERËSIMIT DHE KRITERET

Procesi i përzgjedhjes do të administrohet nga Komisioni i Vlerësimit të Granteve (GRC) i ngritur nga Projekti. Nëse një aplikim futet në listën e shkurtër për financim të mundshëm, aplikantit përkatës mund t'i kërkohet të japë informacione të mëtejshme. Projekti do të vlerësojë propozimet bazuar në kriteret e mëposhtme të vlerësimit të meritës:

Kategoria e Vlerësimit	Klasifikimi Pikët	–
Qasja Teknike	40	
Kapacitetet Profesionale dhe Menaxhuese	30	
Performanca e Shkuar	20	
Efikasiteti i Kostos	10	
Gjithsej	100	

Këto elemente të kriterëve të vlerësimit të meritës përshkruhen plotësisht më poshtë.

Qasja Teknike

a. Zbatueshmëria e Projektit dhe Qasja Teknike

- Shkalla në të cilën raportimi investigativ i propozuar i përgjigjet KPA-së për aplikime dhe adreson në mënyrën e duhur qëllimet dhe objektivat e Projektit për këtë KPA.
- Të tregohet se kuptohen problemet/çështjet që synon të trajtojë kjo KPA;
- Potenciali i raportimit investigativ të propozuar për të arritur me sukses dhe efikasitet objektivat e përcaktuar në Pikën II më lart;
- Një plan i hartuar në mënyrë të qartë, i mirëmenduar, ambicioz, dhe plan real për të kryer raportimin investigativ të propozuar;

b. Qasja Bashkëpunuese (vetëm nëse aplikanti është një partneritet OSHC-ësh të pranueshme)

- Shkalla e bashkëpunimit midis gazetarëve ose ndërmjet gazetarëve dhe OSHC-ve shqiptare në ndarjen e ekspertizës dhe burimeve për zbatimin e qasjeve në funksion të përmbushjes së qëllimeve raportimeve investigative të projektit të jetë e përcaktuar qartë dhe e shpjeguar përmes rolit të secilit partner, pjesëmarrësve dhe kontributeve të përcaktuara.

1. Kapaciteti Profesional dhe Menaxhues si dhe Performanca e Shkuar

a. Kapaciteti Profesional dhe Menaxhues

- Aftësia menaxhuese dhe profesionale e aplikantit(ëve) për të kryer me sukses projektin e raportimit investigativ. Kjo përfshin një vlerësim të:
- Niveli profesional i gazetarit(ëve) dhe OSHC-ëve janë të mjaftueshme për të përmbushur objektivat e përgjithshme të projektit;
- Historiku i mëparshëm dhe angazhimi i aplikantit për të zbatuar aktivitetet e propozuara si dhe aftësia e dëshmuar për të punuar edhe me partnerë të tjerë;
- Përvoja dhe ekspertiza e gazetarit(ëve) investigativ dhe personelit tjetër të projektit të propozuar;
- Dispozita për mekanizmat e duhura të raportimit të projektit.

b. Performanca e Shkuar

- Performanca e shkuar në arritjen e rezultateve pozitive gjatë zbatimit të veprimtarive të ngjashme me ato të propozuara;
- Integritet i plotë profesional dhe personal;
- Aftësia për të përmbushur kërkesat e raportimit dhe llogaridhënies, nëse i akordohet granti nga Projekti;

2. Efikasiteti i Kostos

- Buxheti duhet të jetë (i) i plotë dhe tërësisht i dokumentuar, (ii) i arsyeshëm, dhe (iii) i shpërndarë sipas kategorive të buxhetit;
- Buxheti duhet të tregojë një lidhje të qartë dhe të drejtpërdrejtë midis veprimtarive të propozuara dhe përdorimit të propozuar të fondeve;

- Shpenzimet e propozuara duhet të jenë të lejueshme dhe të alokueshme në projekt.
- Projekti nuk do mbajë përgjegjësi për shëndetin apo sigurinë personale gjatë zbatimit të veprimtarive të mbështetura nga granti.

VII. RREGULLORET PËR AUTORITETIN/QEVERISJES

Mbështetja për akordime ndaj Gazetarisë Investigative do t'i jepet individëve të përshtatshëm si pjesë e Projektit “Drejtësi Për të Gjithë” në Shqipëri. Programi, i financuar nga USAID sipas Aktit të Ndihmës së Huaj të vitit 1961, të ndryshuar, administrohet nga EWMI sipas Kontratën Kryesore nr. AID-182-TO-16-00001. Udhëzime bazë dhe procedura të hollësishme për akordimet janë të përfshira në Manualin e Kontratës të Projektit të USAID-it “Drejtësi për të gjithë”.

Projektit të USAID-it “Drejtësi për të gjithë” i kërkohet të sigurojë që të gjithë aplikantët që marrin fonde grantesh nga USAID, të jenë në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në rregulloret e referuara më lart, sipas zbatimit të termave dhe kushteve përkatëse të akordimit të granteve të tyre.

VIII. PROCEDURAT E DORËZIMIT TË APLIKIMEVE

Projekti do të pranojë aplikime në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Për ata aplikantë që nuk kanë mundësi ta përgatisin propozimin e tyre në anglisht, projekti do ta përkthejë atë. Shembuj për t'u përdorur gjatë përgatitjes së aplikimit janë dhënë në Shtojcën A dhe B. Aplikantët do të dorëzojnë aplikimin e tyre teknik dhe buxhetin në formatet e dhëna dhe ndjekin drejtimet dhe udhëzimet e renditura në këto shtojca.

Aplikimet mund të bëhen nëpërmjet e-mail, ose duke e dorëzuar dorazi në zyrën e projektit në Tiranë, duke përdorur informacionin e kontaktit të dhënë më poshtë.

Paketa e Aplikimit: Paketa e Aplikimit duhet të përfshijë:

1. Shtojca A – Formulari i Aplikimit për Grant
2. Shtojca B– Afatet e Zbatimit të Projektit
3. Shtojca D: Buxhetin e Grantit, ju lutem vini re se **është e detyrueshme** përfshirja e shënimeve mbi Buxhetin (shpjegime të hollësishme) ku do të detajohet në mënyrë të hollësishme lidhja ndërmjet aktiviteteve dhe buxheti;
4. CV(të) e aplikuesit(ve) duke theksuar përvojën e tij/saj/tyre në gazetari dhe, në veçanti, në gazetarinë investigative;
5. Një letër ku të shfaqet angazhimi nga aplikanti(ët) që konfirmon disponueshmërinë e saj/e tij/tyre për të kryer raportimin investigativ brenda afatit të propozuar;
6. Shembu (dy deri në tre) të shkrimeve të mëparshme investigative të kryera më parë nga aplikanti(ët).

Për të shkarkuar paketën e aplikimit, ju lutemi të lexoni lajmërimin e Ftesës për Aplikim në adresën www.ewmi.org. Gjithashtu mund të kontaktoni Projektin në adresën grants_icpp@ewmi.org për të marrë një paketë aplikimi. Kur të bëni kërkesën tuaj, ju lutemi referojuni “RFA-JAG-2017-004”.

Propozimet: Aplikantët duhet t'i dorëzojnë propozimet e tyre dhe dokumentacionin e kërkuar me postë elektronike Projektit në adresën: grants_icpp@ewmi.org. Posta elektronike duhet t'i referohet "RFA-JAG-2017-004" në hapësirën e lëndës. Gjithashtu, aplikimet mund të dorëzohen gjatë orarit të punës dhe në një zarf të mbyllur në adresën:

Attn. GAU: RFA-JAG-2017-004

USAID Justice for All

Rr. Skënderbej, Pallati nr. 8, Shkalla 2, Apart. 823

Tiranë, Shqipëri

Aplikimet e dërguara me fax nuk pranohen.

Aplikimet do të pranohen gjatë gjithë kohës, por nuk do të pranohen më vonë se ora 17:00 më **15 gusht 2017**. Aplikimet e dorëzuara me vonesë ose për të cilat nuk merret përgjigje nuk do të merren në konsideratë.

Propozimet e dorëzuara duhet të jenë punë origjinale dhe vetjake e aplikantit. Plagjiatura rezulton në skualifikim nga konkurrimi për grante.

Projekti do të ruajë të gjithë materialet dhe dokumentacionin e dorëzuar nga aplikantët. Ky informacion nuk do të përdoret për qëllimet të tjera përveç vlerësimit të propozimit dhe nuk do të ndahet me persona apo institucione të tjera, përveç rasteve kur kërkohet nga legjislacioni shqiptar ose nga USAID.

Ju lutemi të vini re se në përputhje me përpjekjet tona për bashkërendimin e donatorëve, ne do të ndajmë emrat e aplikantëve dhe një përshkrim të shkurtër të projekteve të tyre përkatëse me programe të tjera shqiptare dhe ndërkombëtare që mbështesin Gazetarinë Investigative në Shqipëri.

IX. LISTA E SHTOJCAVE

Lista e mëposhtme e shtojcave është pjesë përbërëse e kësaj KPA-je:

Shtojca A – Formulari i Aplikimit për Grant

Shtojca B – Afatet e Zbatimit të Projektit

Shtojca C – Udhëzimet e Buxhetit të Projektit

Shtojca D – Buxheti i Projektit

Ky program granti mundësohet nga mbështetja e Popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e kësaj Ftese për Aplikime është nën përgjegjësinë e plotë të East West Management Institute, Inc. dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.